



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı



01 Nr. 750/24 Dt. 06.12.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 74 të Rregullores nr. 5 për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbime Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**  
**Për formimin e Komisionit**

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (ofertave) të personave juridik dhe fizik, të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike: “Shërbimi i transportit me mjete bartëse (merimanga)” me nr. reference 05-343/148404. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
  - 1.1. Përparim Shala,.....kryesues,
  - 1.2. Laura Suka, .....anëtare,
  - 1.3. Alban Krasniqi,.....anëtar.
2. Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t’i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbime Publike dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Të emëruarve,
  - Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Arkivës së Kryetarit.